



LAJME / KRONIKA E ZEZË

Pas ahengut në Prapashticë, ku u përdorën armë zjarri, policia kontrollon pjesëmarrësit dhe konfiskon armët

6 orë

f

twitter

8



f

twitter

8

Policia e Kosovës të martën në mbrëmje ka pranuar një informatë, ku në një lokacion në rajonin e Prishtinës, përkatësisht në një aheng në Prapashticë, ka pasur gjuajtje me armë zjarri nga persona të dyshuar.

Policia ka vendosur ‘pika kontrolli për automjete’ në lokacione të ndryshme, ku janë ndaluar disa vetura dhe disa persona, të cilët vinin nga ahengu që ishte mbajtura në fshatin Prapashticë.

- LajmeTelegrafi
- Më të lexuarat në Lajme
- 1

Një 14-vjeçare nga Mitrovica bëhet nënë, QKUK lajmëron policinë
- 2

Selmanaj: Kryeministri Hoti e merr bukën nga shtëpia dhe han në zyrë
- 3

Policia e Kosovës parakalon me veturat e reja
- 4

Hisen Berisha: Nëse Specialja ka mandat, pse Presidenti bëri kërkesë për zgjatje të tij?

Gjatë kontrollit, te të dyshuarit L.K. (1988, m/k), është gjetur dhe konfiskuar një revole TT me dy karikatorë të zbrazët; E.K. (1980, m/k), është gjetur dhe konfiskuar një revole me një karikator dhe gjashtë fishekë; B.K. (1988, m/k), është gjetur dhe konfiskuar një revole GLOK 17 me dy karikatorë (njëri nga ta me kapacitet prej 30 fishekëve); D.B. (1968, m/k), është gjetur dhe konfiskuar një revole me një karikator dhe nëntë fishekë”, thuhet në komunikatë.



Po ashtu, dyshohet se një veturë, me qëllim të shmangies së kontrollit policor ka shfrytëzuar një rrugë alternative, por e njëjta është aksidentuar.



“Në SP ‘Veriu’ është shoqëruar edhe organizatori i ahengut I.S. (1988), të cilit i është shqiptuar gjobë për shkelje të Ligjit COVID-19. Policia ka konfiskuar katër armë të shkurta, ka kontrolluar dhe verifikuar 20 persona që ishin në vetura, pjesëmarrës në ahengun në fjalë. Lidhur me rastin është kontaktuar prokurori i DKR në PTH Prishtinë, i cili ka urdhëruar që rasti të procedohet në procedurë të rregullt”, thuhet në komunikatë. /Telegrafi/



Shfaq statistikat COVID-19 ▾

Armë zjarriPolicia e Kosovës



Lokacioni ideal – një prej kriterëve kryesore para blerjes së banesës

Sponzorizuar

Lexo më shumë

CORONAVIRUS

më shumë

Shkupi me 727 raste aktive me COVID-19

Përkeqësohet gjendja e pandemisë në Mal të Zi - pesë të vdekur dhe 197 raste të rej..

Vlerësohet kontributi i diasporës nga Gjermania për luftimin e pandemisë COVID-...

Në Shqipëri do të angazhohen 1,000 mësimdhënës shtesë për të përballuar pandeminë

TELEGRAFI sh.p.k.
Rr. Rexhep Mala, Aktash, Nr.29, Prishtinë, Kosovë
info@telegrafi.com 038-224-093

Partnerët



Ky portal mirëmbahet nga kompania "Telegrafi". Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër për qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Telegrafit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali obligoheni t'i pranoni Kushtet e përdorimit.

Lajme	Stili	Radio Dukagjini	Për ne
Ekonomi	Shendetesia	Smard	Privacy policy
Sport	Teknologji	Telegrafi Jobs	
Magazina	Auto	Marketing	
Femra	Fun	Arkiva	

Na ndiqni:



Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2006-2020 Portali Telegrafi